



REPUBLIKA E SHQIPËRISË Ministria e Shëndetësisë

“Konferenca Rajonale për një Evropë Juglindore të pastër nga Minat“

Programi Paralel për asistencën ndaj të dëmtuarëve nga minat

Z. Arben Ivanaj
Zv. Minister i Shëndetësisë

Zonja dhe Zoterinj,

Të nderuar Pjesëmarrës

Me lejon t'ju uroj mirseardhjen si dhe t'ju falenderoj në emrin tim dhe të Qeverisë Shqiptare për pjesëmarrjen në Programin Paralel për asistencën ndaj të dëmtuarëve nga minat në kuadër të **“Konferencës Rajonale për një Evropë Juglindore të pastër nga minat”**. Kjo Konferencë që mbahet sot në Tiranë është një nga gjashtë konferencat rajonale në mbarë botën, të cilat i paraprijnë Konferencës së Dytë të Rishikimit mbi Konventën për Ndalimin e Përdorimit, Magazinimit, Prodhimit dhe Transferimit të Minave kundër Personit si dhe Asgjësimit të tyre.

Siç jeni në dijeni, Shqipëria vuan problemin e ndotjes me mina që nga përfundimi i konfliktit në Kosovë në vitin 1999. Ndotja me mina dhe municione të paplasura në rajonin verilindor të Shqipërisë ndikoi drejtpërdrejtë në jetën e më shumë se 25,000 personave në 39 fshatra. Prej vitit 1999 deri më sot 34 persona kanë vdekur dhe 238 të tjerë janë plagosur si rezultat i aksidenteve me mina.

Ne të mbledhur sot këtu dhe sidomos të aksidentuarit nga minat, jemi dëshmitarët më të mirë të vuajtjeve dhe pasojave të rënda që minat dhe municionet mund të shkaktojnë në jetën e njerëzve.

Shqipëria ka ratifikuar që në vitin 2000 **Konventën për Ndalimin e Minave** kundër personit dhe në përputhje me obligimet që rrjedhin nga kjo Konventë, Qeveria Shqiptare e mbështetur nga donatorë ndërkombëtarë dhe lokalë ka ndërmarrë një sërë iniciativash në përmirësimin e kapaciteteve shëndetësore dhe Rehabilituese si dhe projekte në përmirësim të ri-integrimit social ekonomik të këtyre të dëmtuarëve nga minat. Dje ju keni patur mundësinë të vizitoni disa nga këto kapacitete, si ato në spitalin Rajonal të Kukesit, të cilat tashmë janë pjesë e plotë e strukturave shëndetësore dhe do të jenë vazhdimisht në përmirësim. Gjithashtu nëpërmjet programit të PMR (faza I & II) janë ngritur kapacitetet e formimit të profesionistëve në lëmin e Fizioterapisë në Fakultetin e Infermierisë, si

dhe po kryhet trajnimi përkatës për mjekët fiziatër dhe tekniket e protezimit, duke u mbështetur në module që përdoren në shkollat me të mira të BE.

Gjate kësaj periudhe nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë një vëmendje e veçantë i është kushtuar realizimit të reformave të rëndësishme të ndërmarra në sistemin tonë shëndetësor me qëllim fuqizimin dhe shtrirjen e këtij kujdesi në të gjithë zonat e vendit dhe mundësimin e aksesit për këto shërbime nga e gjithë popullata. Një nga prioritetet e MSH në vëmendje të veçantë për personat e dëmtuar dhe me aftësi të kufizuara ka qenë ngritja, organizimi, forcimin dhe shtrirjen e sistemit të urgjencës mjekësore për të cilën janë bërë edhe investime të rëndësishme si dhe rritja e cilësisë në fushën e rehabilitimit fizik. Edhe për vitet e ardhshme investimet në këto fusha nuk do të mungojnë duke synuar në një shërbim shëndetësor cilësor dhe të arritshëm.

Në vazhdim të ditës së sotme ju do të analizoni progresin e bërë dhe sfidat me të cilat përballë rajoni ynë për të përmirësuar jetën e njerëzve të prekur drejtpërdrejt nga ky problem serioz si dhe për të përmbushur objektivat kundrejt asistencës ndaj të dëmtuarëve nga minat në Konventën e sipërpërmendur. Une jam i bindur se sot ju do të shkëmbeni eksperiencat tuaja pozitive nga puna juaj e përditshme, që do të shërbejë për të forcuar dhe më tepër lidhjet në nivel rajonal e më gjerë.

Une jam i bindur se ky është forumi ideal ku ju të aksidentuarit nga minat dhe municionet nga vende të ndryshme të rajonit të artikulonim më së miri nevojat, problemet dhe prioritetet që keni. Përfshirja juaj në çdo proces dhe vendimarrje, tashmë është një eksperiencë e domosdoshme dhe pozitive e vërtetuar. Në këtë mënyrë dhe ne do të kemi mundësinë të eksplorojmë më mirë nevojat në këtë fushë, si dhe shpresojmë të kemi si deri tani, edhe mbështetjen e vendeve donatore në përmbushjen e premtimeve dhe obligimeve për të dëmtuarit nga minat.

Gjithashtu, duke ju uruar suksese dhe shpresuar në kontributin tuaj të çmuar në këtë konferencë, dëshiroj ta mbyll duke falenderuar partnerët tanë lokalë dhe ndërkombëtare për punën e përbashkët që kemi bërë, një mirënjohje të veçantë për donatorët e Programit Shqiptar të Veprimtari ndaj Minave, pasi pa kontributin e tyre vështirësitë do të ishin të mëdha.

Në të njëjtën kohë keni premtimin dhe angazhimin tonë për bashkëpunim të ngushtë në të ardhmen pasi vetëm me përkushtimin e përbashkët mund të sigurojmë një jetë më të mirë për të aksidentuarit nga minat duke përmbushur kështu obligimet dhe premtimet tona kundrejt tyre.

Faleminderit për vëmendjen tuaj,